



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.56/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës të kandidatit të pavarur Rufki Suma, për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, duke vendosur sipas ankesave të ushtruara nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), përmes të autorizuarit të saj Faton Fetahu avokat në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin në vazhdim shkurt PZAP) Anr.693-2/2021 të datës 27.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.10.2021, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Lëndët e regjistruara në Gjykatën Supreme sipas ankesës të kandidatit të pavarur Rufki Suma, për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, me numër AA.nr.56/2021, dhe sipas ankesës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me numër AA.nr.57/2021, të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.693-2/2021 të datës 27.10.2021, bashkohen në një lëndë dhe udhëhiqen sipas lëndës me numër AA.nr.56/2021.

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e kandidatit të pavarur Rufki Suma, për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, dhe ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, të paraqitura

kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.693-2/2021, të datës 27.10.2021.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP) Anr.693-2/2021, të datës 27.10.2021, është vendosur në pikën I, të pranohet pjesërisht e bazuar ankesa Anr.693/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga kandidati i pavarur Rufki Suma, nga Komuna e Hanit të Elezit, ndërsa Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 10,100.00 euro (dhjetëmijë e njëqind), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021. Në pikën II, është detyruar subjekti politik Partia Demokratik e Kosovës, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën I, të dispozitivit të vendimit, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e dënimit shtesë. Në pikën III, është refuzuar si e pabazuar pjesa e ankesës së kandidatit për kryetar të Komunës në Han të Elezit, Rufki Suma kandidat i pavarur, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Procesi i Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune, për shkak të minimumit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme ka parashtruar Rufki Suma, kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, më datë 22.10.2021, me të cilën konteston ligjshmërinë e këtij vendimi, duke propozuar që ankesa të pranohet, dhe Gjykata Supreme ta aprovoi në tërësi ankesën e parashtruar duke e anuluar Procesin e Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune, për shkak të minimumit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme ka parashtruar edhe subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), përmes të autorizuarit të tij Faton Fetahu avokat në Prishtinë, më datë 22.10.2021, me të cilën konteston ligjshmërinë e këtij vendimi si në pikën I, të dispozitivit,

duke propozuar që ankesa të pranohet, dhe Gjykata Supreme të anuloi vendimin e lartpërmendur të PZAP-it, dhe çështja t'i kthehet PZAP-it, në rivendosje proporcionale të gjobës në pajtim me gjendjen faktike dhe legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje të ankesës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të atakuar, pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje në ankesë, shqyrtoi shkresat e tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidati i pavarur Rufki Suma, për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve, me veprimet e tyre gjatë netëve të fundit para Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, simpatizantët e PDK-së, kanë bërë presion mbi qytetarët, ku çdo qytetar e kanë përcjellë me veturë dhe i kanë bërë ultimatum që të mos futet nëpër shtëpi, dhe se dyshon që janë shpërndarë mjete për blerje të votave. Parashtruesi i ankesës thekson se e kanë lajmëruar Policinë e Kosovës, por të njëjtit nuk kanë dalë për të shpërndarë turmën e njerëzve, se ka pasur vizita të simpatizantëve në vendvotime siç është Paldencë dhe Gorancë. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se sipas raportimit të vëzhguesve të tij, është njoftuar se në ditën e zgjedhjeve kandidati për kryetar nga radhët e PDK-së Mehmet Balazhi dhe kandidatët për kuvend komunal të këtij subjekti, kanë vizituar të gjitha vendvotimet në Hanin e Elezit, në Seçishtë, Gorancë, e Paldenicë. Fjalët që i kanë përdorur në vendvotime janë “si jeni, a jeni lodh, a keni ndonjë problem”, kurse në korridor me votuesit "votoni nr. 177 dhe numrat e kandidatëve”, këto shihen në kamerë, por nuk dëgjohet zëri. Menjëherë pas pranimit të informatës si subjekt, është njoftuar KKZ-ja, dhe Policia e Kosovës, por nga të njëjtit nuk është ndërmarrë asnjë masë. Ankesës i ka bashkangjitur CD, me video, me propozim për Panelin që të aprovohet ankesa dhe të anulohet votimi në këtë komunë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me vendimin Anr.693/2021, të datës 21.10.2021, ka vendosur të aprovohet si e bazuar ankesa e kandidatit për kryetar të Komunës në Han të Elezit, Rufki Suma, kandidat i pavarur, e cila mban shenjë A.nr. 693/2021 e datës 18.10.2021, dhe është anuluar Procesi i Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar të Komunës,

për shkak të minimit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve. Si dhe është urdhëruar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ta përsërisë votimin vetëm për Kryetar të Komunës në Qendrat e Votimit (QV) Nr. 33010, 3302d, 3303d dhe 3304d, të gjitha në Komunën e Hanit të Elezit.

Gjykata Supreme duke vendosur sipas ankesës së Mehmet Ballazhi, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me vendimin e saj AA.nr.52/2021, datë 23.10.2021, ka pranuar ankesën dhe çështjen ka kthyer në rivendosje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në ri-procedurë, me vendimin Anr.693-2/2021, të datës 27.10.2021, i atakuar sipas ankesave, ka vendosur të pranohet pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga kandidati i pavarur Rufki Suma, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të përshkruar si më lartë.

Në arsyetimin e tij në vendim, PZAP thekson se paneli, nga shikimi i katër mesazheve të komunikimit përmes telefonit, dhe komunikimet në rrjete sociale “Facebook”, ka vërejtur se si mbështetësit e subjektit politik PDK, janë organizuar se si të dalin për të votuar dhe duke u organizuar se si të bëhet bartja e votuesve deri në Qendra të Votimit, po ashtu shihet se si janë kujdesur që të votojnë të gjithë familjarët e tyre, duke dërguar edhe foto tek njëri tjetri me fletëvotim të plotësuar tek numri garues në këto zgjedhje i subjektit politik PDK. Me CD-1, që përbëhet prej dy video incizimeve, Paneli vëren nga video në gjatësi të xhirimit prej 1 minutë e 34 sekonda, dy persona duke hyrë në një Qendër Votimi, por nga e njëjta video nuk mund të identifikohet se kush janë këta persona dhe në cilën Qendër Votimi kanë hyrë. Ndërsa nga video incizimi me gjatësi të xhirimit prej 2 minuta e 57 sekonda, konstatohet se kandidati për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit Muhamet Ballazhi del nga Qendra e Vendvotimit, dhe ndalet për të biseduar me një person posa del nga Qendra e Vendvotimit, bisedë e cila ka zgjat 2 minuta e 19 sekonda, posa ndahet nga personi që ishte duke biseduar sërish ndalet për të biseduar edhe me një person tjetër për 15 sekonda. Me CD-2, Paneli konstaton një veturë me ngjyrë të bardhe e cila ndalet në një udhëkryq dhe bisedon edhe me drejtues tjerë të automjeteve, mirëpo nga kjo video nuk mund të vërtetohet se cili ishte qëllimi i ndaljes së asaj veture në atë udhëkryq dhe çka bisedon drejtuesi i këtij automjeti me drejtues tjerë të automjeteve që ishin ndal tek i njëjti. Nga Raporti i KQZ-ës i datës 22.10.2021 lidhur me rrjedhën e procesit zgjedhor në ditën e Zgjedhjeve Lokale, të datës 17.10.2021, për Komunën e Hanit të Elezit, Paneli konstaton, se në KKZ-në e Hanit të

Elezit, nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim si e dokumentuar, po ashtu asnjë telefonatë për ndonjë incident nëpër Qendrat e Vendvotimit, apo në Vendvotime nga Menaxherët e QV-ve, Kryesuesit e KVV-ve, Anëtarët e KVV-ve, Vëzhguesit e Subjekteve Politike, po ashtu as nga vëzhguesit ndërkombëtar. Kështu që KKZ-ja ka siguruar se informatat e dala në media lidhur me pretendimet e Rufki Sumës për proces jo të rregullt të votimit, nuk qëndrojnë, sepse në KKZ, askush nuk ka paraqitur ndonjë ankesë eventuale për parregullsi gjatë këtij procesi të votimit. Nga Librat e Votimit 3301D/OIR, 33010/02R, 3302D/01R, 3302D/02D, 3303D/OIR, 3303D/01R, 3304D/01R, 3304D/02R, Deklaratat e Menaxherëve të QV-ve 3301D, 3302D, 3303D dhe 3304D, Paneli konstaton se në këto libra të votimit nuk është paraqitur respektivisht evidentuar asnjë parregullsi gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve lokale të datës 17.10.2021. Ndërsa nga Librat e Votimeve, për Vendvotimet 33010/03R, 33010/04D, 3303D/02D, 3304D/03D, Paneli konstaton se në ditën e votimit janë vizituar nga kandidati për kryetar i Komunës së Hanit të Elezit, nga radhët e subjektit politik PDK, i cili i ka përshëndetur anëtarët e KVV-ve, duke ju thënë, që mos të lodhen, si janë dhe të jenë transparent". Nga Raporti i Policisë së Kosovës i datës 26.10.2021, Paneli konstaton se lidhur me procesin e votimit në ditën e Zgjedhjeve Lokale të 17 tetorit 2021 në Komunën e Hanit të Elezit, në Stacion Policor nuk është pranuar asnjë ankesë nga asnjë menaxher i QV-ve, apo ndonjë zyrtar i zgjedhjeve, që ka të bëjë me krime zgjedhore të përmendura në Kapitullin 18 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

PZAP më tej thekson se pas vlerësimit të secilës provë si më lart dhe të gjitha provave në tërësinë e tyre, vjen në përfundim se kandidati për kryetar të komunës së Hanit të Elezit nga radhët e subjektit politik PDK, e ka thyer heshtjen zgjedhore në ditën e votimit, me vet faktin se kandidati i lartcekur ka vizituar edhe vendvotime tjera në ditën e votimit siç është konstatuar më lart, ngase vizita e kandidatit për Kryetar Komune pa qenë votues, është bazë e mjaftueshme për tu konstatuar se nga ana e tij është thyer heshtja zgjedhore. Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik PDK, është përgjegjëse për veprimet e tij, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se "24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre", që në këtë rast vetë prezenca e kandidatit në fjalë nëpër vendvotime pa qenë votues në ato vendvotime është bërje e fushatës në njëfarë mënyre. Paneli, me rastin e shqiptimit

të gjobës si në dispozitiv të vendimit, është mbështetur në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë Paneli e mori faktin se subjekti politik PDK, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, dhe ka marr mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore. Dhe se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore-zgjedhore, dhe si të tilla cenojnë klimën e qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar, si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Sa i përket vendosjes si në pjesën refuzuese të ankesës, për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli ka konstatuar se me asnjë nga provat e vlerësuara si më lart nuk është vërtetuar se është ushtruar ndonjë ankesë për ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim, po ashtu as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo kallzim penal, që ka të bëjë me presionin që iu është bërë votuesve siç pretendohet nga ankuesi, vizita e kandidatit për kryetar të komunës në katër vendvotime edhe pse nuk ishte votues, nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat, për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimet e pretenduara, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se ka pasur parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, pasi për t'u dërguar në rivotim një apo më shumë qendra të votimit, vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore shumë serioze, si rezultat i të cilave procesi i votimit të jetë minuar dhe që zgjedhjet të dalin pa integritet.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, pasi që vendimi i kundërshtuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka konstatuar gjendjen faktike, dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, me rastin e vendosjes si vendimin e ankimuar, si në dispozitiv të tij, duke i shqiptuar dënim me gjobë Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, në lartësi prej 10,100.00 euro (dhjetëmijë e një qind), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021, si dhe është refuzuar si e pa bazuar pjesa e

ankesës së kandidatit për kryetar të Komunës në Han të Elezit, Rufki Suma kandidat i pavarur, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Procesi i Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune, për shkak të minimit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.

Vendimi i kontestuar nga subjektet politike ankuese në këtë çështje në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, ndërsa përfundimi ka mbështetje të plotë në arsyet e dhëna nga Paneli, si për gjendjen faktike të çështjes, për procedurën e hetimit nga Paneli, e po ashtu edhe për të drejtën e zbatuar me rastin e vendosjes për apelet e subjekteve politike. Në këtë kontekst vlerësohet se vendimi i kundërshtuar ka kronologji dhe koherencë si për aspekte faktike dhe juridike të çështjes, me arsyet të plota dhe bindëse për secilin fakt të konstatuar, për peshën që ka secili fakt i konstatuar në vendimmarrjen e Panelit, për mjetet provuese të shfrytëzuara, për fuqinë provuese të mjeteve provuese të shfrytëzuara dhe për mënyrë se si paneli ka arrit në përfundimin lidhur me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës në Han të Elezit, Rufki Suma.

Gjykata Supreme, e pranon në tërësi gjendjen faktike të konstatuar nga PZAP, pasi që me provat që gjenden në shkresat e lëndës provohet në mënyrë të plotë dhe të besueshme gjendja faktike e konstatuar nga PZAP. Nga provat në shkresat e lëndës vërtetohet se kandidati Mehmet Ballazhi, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), gjatë ditës së zgjedhjeve (fakt që nuk është kontestuar, madje edhe është pranuar publikisht në media edhe nga vet i autorizuari i tij avokati Faton Fetahu), ka vizituar qendrat e vendvotimeve në Komunën e Hanit të Elezit, që paraqet shkelje sipas nenit 36 të Ligjit NR. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu Gjykata Supreme pajtohet me lartësinë e gjobës së shqiptuar, në shumën prej 10,100.00€, pasi arsyet e dhëna nga PZAP, janë bindëse, për faktin se shkelësi i dispozitës ligjore, të lartëcekur, është kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i cili subjekt ka një traditë të gjatë, që nga pas lufta, me pjesëmarrje në të gjitha zgjedhjet e organizuara lokale dhe të përgjithshme. Andaj duke marrë parasysh këtë rrethanë, asnjë justifikim si në pretendimet ankimore nuk mund të merret parasysh, pasi natyra e shkeljes është e rëndë, e bërë me vullnet, për të cilën shkelje kandidati për kryetar ka qenë dashtë të di, se nuk është e lejuar, ndërsa mos dija nuk mund të merret si rrethanë për shqiptimin e një gjobe më të ulët, pasi

për këtë lloj të shkeljes, lartësia e gjobës është paraparë deri në 50,000.00€, andaj shuma e gjobës së shqiptuar është proporcionale.

Gjykata Supreme ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruara nga Rufki Suma, kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, më datë 22.10.2021, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të atakuar në pjesën refuzuese, duke propozuar që ankesa të pranohet, dhe Gjykata Supreme të aprovojë në tërësi ankesën e parashtruar duke e anuluar Procesin e Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune, për shkak të minimit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve, por ky pretendim është i pabazuar për faktin se pretendimet e parashtruara me apelet e paraqitura nuk e kanë bërë të besueshme kërkesën, ndërsa derisa kërkesa nuk është e besueshme PZAP, me të drejtë ka refuzuar kërkesën si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme me vëmendje ka vlerësuar çdo pretendim të ushtruar dhe provat e prezantuara, por vlerëson se të njëjtat prova, mesazhet e dorëzuara të komunikimit në mes personave të ndryshëm, në shumicën e rasteve njëri nga personat i paidentifikuar, të cilët nuk përmbajnë data, si dhe se në çfarë forme janë siguruar, po ashtu edhe nga CD-të e prezantuara si provë, nuk mund të arrijmë në përfundim se pretendimet në ankesë janë të bazuara, nuk janë prova bindëse për të vendosur se ekzistojnë shkeljet e pretenduara si në ankesë.

Gjykata Supreme në asnjë mënyrë nuk mund t'i lejojë vetes që përmes këtyre provave të pranojë ankesën dhe të lejojë rivotimin për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, ndonëse me nenin 120 të Ligjit NR. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe ndryshimeve të tij, në paragrafin 1, pika b) është përcaktuar se “para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulohet rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-ën ta përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale”, që do të thotë se shkeljet duhet të jenë të tilla që kanë pasur ndikim në rezultatin përfundimtar, që në rastin konkret asnjë nga shkeljet, as shkelja e kandidatit Mehmet Ballazhi, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i cili gjatë ditës së zgjedhjeve ka vizituar qendrat e vendvotimeve në Komunën e Hanit të Elezit, nuk ka asnjë indikacion se ka mundur të ketë ndonjë ndikim në rezultatin përfundimtar, kjo edhe për faktin se në bazë të dokumentacionit zgjedhor të

KQZ-së, në shkresat e lëndës nuk ka shkelje dhe procesi zgjedhor në Komunën e Hanit të Elezit ka qenë i rregullt.

Nëse do të ndjekim këtë logjikë që për një shkelje të caktuara të anulohet procesi zgjedhor, do të vihej në pikëpyetje nëse do të mund të përfundonin zgjedhjet ndonjëherë, por e rëndësishme është që shkeljet të mos kenë ndikim në rezultatin përfundimtar, edhe në zgjedhjet e kaluara PZAP ka shqiptuar gjoba për shkelje nga neni 36 i LZP, të cilat janë konfirmuar nga Gjykata Supreme, dhe për nga pesha dhe mënyra e kryerjes kanë pasur ndikim shumë më të madh, shih vendimin e Gjykatës Supreme AA.nr.20/2021, me datë 19 shkurt 2021, me të cilin është konfirmuar vendimi i PZAP, me të cilin është shqiptuar gjoba prej 25,000. 00 €, (njëzetepesëmijë euro), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 14.02.2021, si dhe vendimin AA.nr.13/2020 datë 8 dhjetor 2020, me të cilin është refuzuar ankesa kundër vendimit të PZAP-it, me të cilin është shqiptuar dënimi me gjobë prej 20.000, 00 €, në emër të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në ditën e votimit për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën Mitrovica e Veriut, të mbajtura me 29.11.2020, andaj edhe pretendimet që kandidati Mehmet Ballazhi, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, t'i shqiptohet ndonjë nga masat nga neni 120 i LZP, konkretisht 120.3, është tërësisht e pabazuar.

Ndërsa pretendimi si në ankesë se kandidati nuk është dënuar, është i pabazë, pasi PZAP, gjobën e ka shqiptuar konform dispozitës ligjore nenit 120 të Ligjit NR. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe ndryshimeve të tij, në paragrafin 1, pika b) është përcaktuar se PZAP mund “të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro(50,000) Euro.”, që do të thotë sipas vetë dispozitës ligjore është përcaktuar se gjobitët subjekti politik, dhe jo kandidati.

Gjykata Supreme ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruara lidhur me faktin se janë kryer vepra penale, por në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet nëse ka apo nuk ka vepra penale, qoftë nga kandidati Mehmet Ballazhi, kandidat për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, apo nga persona tjerë, andaj edhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi, pasi fakti se dikujt i është shqiptuar një gjobë apo sanksion tjetër, nuk do të thotë se ndaj të njëjtit nuk mund të zhvillohet procedura penale, dhe të njëjtit të gjenden fajtorë.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.56/2021, datë 28.10.2021

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Fejzullah Rexhepi